

VENDIM
Nr.6, datë 16.2.2010

PËR LICENCIMIN E OPERATORIT SHA UJËSJELLËS, VLORË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence.....” Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të licencojë operatorin sh.a. Ujësjiellës, Vlorë me:
 - Drejtues ligjor z. Viron Toli Hyso
 - Drejtues teknik znj. Albina Rushdi Xhyheri.
2. Operatori licencohet në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri më datë 16.2.2014.
4. Zona e shërbimit të këtij operatori është:
Bashkia: Vlorë
Komuna: Qendër
Fshati: Babicë, Nartë, Zvërnec.

KRYETARI
Avni Dervishi